



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38, paragrafi 2, 39 paragrafi 16, Ligji Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës, Bordi Mbikëqyrës i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO			
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE			
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA			
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY			
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	01	NR.PROT. BR.PROT. NR.PROT.	399
NUMRI I FAGEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	11	DD.MM.VVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:	12/03/2017
PRISHTINË / A			

Rregullore Nr. 01/2017 për Taksa dhe Gjobat

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i Rregullores është përcaktimi i rregullave dhe procedurat për realizimin e taksave dhe vendosjen e gjobave nga ARH-ja. Me këtë Rregullore, ARH definon shumën fikse të taksave në fushën e Licencimit, Sigurisë, Rregullimit të Tregut dhe Interoperabiliteti, si dhe përcaktimin e shumës fikse të gjobave për personat juridik dhe fizik.

Neni 2 **Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjitha llojet e të hyrave të cilat gjenerohen si rezultat i gjobave dhe taksat për: aplikacion dhe marrje të licencës, aplikacion dhe marrje të autorizimeve të sigurisë, aplikacion dhe marrje të certifikatës së sigurisë, aplikacion dhe marrje të autorizimeve të futjes në shërbim për mjetet e reja, aplikacion dhe marrje të autorizimeve të futjes në shërbim për mjetet e riparuar, aplikacion dhe marrje të autorizimeve të futjes në shërbim për infrastrukturë, aplikacion dhe regjistrim të mjeteve lëvizëse, aplikacion dhe ri-regjistrim/modifikim të mjeteve lëvizëse, aplikacion dhe marrje të kodit të VKM (shenjëzimi i mbajtësit të mjetit lëvizës), etj.

Neni 3 **Definicionet**

‘gjobë ‘ nënkuptojnë të gjitha gjobat apo ndëshkimet të parapara nga neni 143 i ligjit për hekurudhat e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-063 si dhe Aneksin II të kësaj rregullore;

‘licencë’ nënkupton licencë për Menaxherin e Infrastrukturës, Ndërmarrjet Hekurudhore, dhe Makinistët;

‘autorizim i sigurisë’ nënkupton autorizimi i sigurisë për Menaxherin e Infrastrukturës;

‘certifikatë e sigurisë’ nënkupton certifikata e sigurisë për Ndërmarrjen Hekurudhore;

‘autorizimi i futjes në shërbim’ nënkupton autorizimin për futjen në shërbim të mjeteve lëvizëse dhe infrastrukturës;

‘regjistrim i ri’ nënkupton regjistrimin e mjetit lëvizës hekurudhore për herë të parë nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave dhe përfshirjen e tij në Regjistrin Nacional të Mjeteve Lëvizëse NVR (Nacional Vehicle Registration);

‘modifikim/ri-regjistrim’ nënkupton çfarëdo veprimi i cili do të ndikojë në modifikimin e njëjës apo më shumë pikave në formularin e regjistrimit;

